

“NDIKIMI I MËNYRAVE TË SHARTIMIT DHE NËNSHARTESËS NË PARAMETRAT CEILËSOR TË FIDANIT TË MOLLËS”

ABSTRAKTI

Shartimi është bazë kryesore teknike me të cilën fidanët e mollës. Përmes shartimit bëhet bashkimi i nënshartesës dhe mbishartesës, të cilat mund të kenë tipare të ndryshme dhe që po ashtu mund të kenë ndikim në zhvillimin e njëra tjetrës. Ekzistojnë mënyra të ndryshme të shartimit përmes të cilave bëhet bashkimi i këtyre dy komponentëve. Suksesi i bashkimit të tyre varet nga disa faktorë si përputhshmëria, afiniteti, koha e shartimit, teknika e shartimit etj. Ky studim ka për qëllim të vë në pah ndikimin e disa prej këtyre faktorëve në arritjen e disa parametrave biomorfologjik të zhvillimit të fidanit të mollës. Në rastin tonë janë testuar tri teknika të ndryshme të shartimit me bashkim – kopulim (përputhje, përputhje të përmirësuar dhe omegë) dhe tri nënshartesa vegetative të ndryshme të mollës (M 9, M 26 dhe MM 106) të shartuara me kultivarin Red chief. Studimi është kryer në vitin 2022, nënshartesat (copat e rrënjëzuara) dhe kalemrat për shartim janë marrë në fermën didaktike të FBV-së, ndërsa pas shartimit eksperimenti është vendosë në fshatin Rudicë komuna e Istogut. Përmes hulumtimit është arritur në përfundim se teknikat e shartimit me përputhje dhe me përputhje të përmirësuar janë treguar më të suksesshme në zhvillimin e fidanit në raport me teknikën omegë. Gjithashtu janë vërejtur ndryshme në disa parametra të zhvillimit të fidanëve edhe në mes nënshartesave të cilat tipareve e ndryshme gjenetike të bujshmërisë deri në një masë i kanë shfaqë edhe tek fidanët.

Fjalët kyçe : Molla, kultivari, nënshartesa, shartimi, fidani

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Drinor Mehmeti